

**VENDIM**  
**Nr. 211, datë 31.3.2021**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E  
SUPERVIZIMIT E TË KOLAUDIMIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE DHE NJËSIVE  
TË BANIMIT NË NDËRTEA (PALLAT), NË BASHKINË KAMZË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nëndarja “i”, 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 14 820 655 (katërmëdhjetë milionë e tetëqind e njëzet mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, për financimin e supervizimit e të kolaudimit të rindërtimit dhe rikonstruksionit të 9 (nëntë) objekteve arsimore, si dhe të rforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) të ndara me lote, në Bashkinë Kamzë.

2. Efekti financiar sipas pikës 1, të këtij vendimi, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, dhe i transferohet Bashkisë Kamzë në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë e Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**